

V E N D I M
Nr.412, datë 17.8.1993

**PËR VENDOSJEN E SISTEMIT KABLLOR NËNDETAR NDËRKOMBËTAR ME
FIBËR OPTIKE DUBROVNIK-DURRËS-KORFUZ (PROJEKTI "ADRIA-1")**

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve dhe të Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të vendosjes në ujrat tona territoriale të sistemit kabllor nëndetar ndërkombëtar me fibër optike me intenerar Dubrovnik-Durrës-Korfuz (projekti "ADRIA-1).

2. Lejimin e hyrjes së anijes kroate "JUNAK-9 AKB" për të kryer studimin e bregut për futjen e kabllit nëndetar në Durrës.

Për këtë të vepohet në përputhje me kërkesat procedurale të vendosura nga Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve në Durrës.

Leja e hyrjes së anijeve të tjera të huaja të specializuara për studimin, shtrirjen dhe riparimin e kabllit nëndetar të projektit "ADRIA-1" dhe informacionet përkatëse për bregdetin nga kalon traseja e kabllit jepen nga Ministria e Mbrojtjes, sipas procedurave e rregullve të caktuara prej saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi